



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-III.-13-0463

Paditësi:

G.R., Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati

Kundër

E paditura:

KBI “P” NSH “LB”, të cilën e administrojnë **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “*Agim Ramadani*”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kolegji i përbërë nga Teuta Ibrahim, gjyqtare kryesuese, Manushe Karaçi dhe Hajrie Shala, gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 shtator .2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. **Kërkesa për masë të sigurimit, refuzohet si e pabazuar.**
2. **Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 17 shtator 2013, paditësi ka parashtruar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje DHPGJS), i përfaqësuar me autorizim nga av. M.S., nga Prizreni kundër të paditurave. Paditësi kërkon nga Gjykata që të vërtetohet se paditësi është pronar dhe posedues i patundshmërive në Prizren të regjistruara si:

-parcela kadastrale nr. 608/7, në sipërfaqe prej 9 ari e 22 m² nga fletëposedimi nr. "I Ri" ZK D, në vendin e quajtur "BT", are e kl. 3 në bazë të blerjes prej shitësit E.F. nga Prizreni, me Kontratën mbi shitblerjen e pasurisë së patundshme të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr. 894/89 të datës 16 mars 1989 dhe,

- parcelës kadastrale nr.605/10 në sipërfaqe prej 13 ari e 70 m², nga fletëposedimi nr. "I RI" ZK D në vendin e quajtur "BUZATILO", are e kl.3, në bazë të blerjes prej shitësit E.F. nga Prizreni, me Kontratën mbi shitblerjen e pasurisë së patundshme të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr.555/88 të datës 08 shkurt 1988.

Këto paluajtshmëri janë të regjistruara si pjesët parcelave kadastrale nr.608/1 dhe nr.609, të dyja në Zonën Kadastrale D në emër të KBI "P" nga Prizreni.

Me padi është kërkuar që të obligohet e paditura KBI "P" nga Prizreni që këtë ta pranojë dhe të lejojë regjistrimin e tyre në emër të paditësit në Librat e Drejtorisë Komunale të Kadastrit në Prizren në kufij dhe dimensionet (sipas mendimit të ekspertit të gjeodezisë) si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës të gjitha në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit me kërçenim të ekzekutimit të dhunshëm.

Më 18 dhjetor 2015, paditësi/propozuesi i përfaqësuar me autorizim nga av. M.S., nga Prizreni ka parashtruar propozim për shqyrtimin e vendimit të Zyrës Rajonale të AKP-së në Prizren për N.SH. "LB" Prizren në Likuidim.

Propozimit i bashkangjet edhe kopjen e Vendimit me të cilin AKP-ja gjegjësisht Autoriteti i Likuidimit kërkesën e paditësit lidhur me pretendimet pronësore mbi parcelat kadastrale nr. 608/7 në sipërfaqe prej 0,09.22 ha, dhe parcelën tjetër me nr. 605/10 në sipërfaqe prej 0,13.70 ha në vendin e quajtur "Buzatilo" , Zona Kadastrale Prizren, e refuzon si të pavlefshme.

Më 23 shkurt 2016, e paditura e parë AKP-ja, ka parashtruar mbrojtje në padi, në të cilën e kundërshton padinë dhe pretendimet e paditësve si të pa bazuara në ligj. Sipas AKP-së kërkesëpadija është e pathemeltë në kuptim të nenit 399 të LPK-së pasi që faktet në të cilat mbështetet padia janë në kundërshtim me provat të prezantuara nga paditësi.

Ekzistojnë kundërthënie në mes të fakteve në të cilat mbështetet kërkesëpadija dhe provave të cilat janë bashkangjitur me padi. Provat e propozuara tregojnë një gjendje tjetër faktike dhe juridike e kundër nga kërkesëpadija. Nga shkresat e lëndës shihet se paditësi ka pretendime për dy ngastra kadastrale (605/10 dhe 608/7).

AKP-ja në mbrojtje gjithashtu thekson se Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren e ka njoftuar paditësin se ngastra 608/7 është pronë private e cila figuron në emër të personave privat (Sh.H.dhe D.H.) ndërsa sipas historiatit ngastra kadastrale nr. 605/10 nuk ekziston fare.

Përmes mbrojtjes së saj AKP-ja kërkon nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës që të refuzojë padinë e paditësit si të pabazuar.

Më 21 gusht 2019, paditësi G.R., përmes avokatit të autorizuar S.R., dorëzon në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme propozim për caktimin e masës së sigurimit që t'iu ndalohet të

paditurve që: paluajtshmëritë e evidentuara sipas matjeve të kadastrit: ngastra kadastrale nr. **608/7** në sipërfaqe prej 9 ari e 22m² ZK D dhe ngastra kadastrale nr. **605/10** në sipërfaqe prej 13 ari e 70 m² ZK D, të mos barten te personat e tretë, të mos bëhet ndërtimi, shitja apo ndërrimi, të mos ngarkohen me hipotekë apo në ndonjë formë tjetër të disponojnë ose ngarkohen paluajtshmëritë e lartcekura, derisa nga ana e Dhomës së Posaçme, sipas padisë së paditësve të përfundojë dhe të bëhet e plotfuqishme procedura gjyqësore e cila është në procedurë e sipër.

Më 22 gusht 2019 gjyqtarja e Dhomës së Posaçme lëshon një urdhër për AKP-në bashkë me padinë dhe kërkesën për masën e sigurimit të parashtruara nga paditësi. Nga AKP-ja (e paditura e parë) kërkohet që brenda shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri, të paraqesë përgjigjen e saj.

Më 27 gusht 2019 AKP-ja dorëzon përgjigjen e saj në kërkesën për masën e sigurimit dhe e kundërshton në tërësi kërkesën e paditësit si të pabazuar në ligj ngase nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga Neni 66.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme si dhe elementet që parashihen me Nenin 253 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 dhe Nenin 35 Ligjit për Dhomën e Posaçme nr. 06/L-086.

AKP-ja konsideron se për këtë padi ekziston litispendenca dhe në kuptim të nenit 391 paragrafi c) i LPK-së, kjo padi duhet të hedhet poshtë.

Në kundërshtim të kërkesës për masën e sigurimit AKP-ja përmend faktet se: prona nuk është shoqërore siç pretendon pala, e paditura nuk administron me prona private, nuk ka rrezik për dëm të riparueshëm sepse paditësi nuk ka dëshmuar asnjë të drejtë pronësore mbi pronën kontestuese.

AKP-ja në fund kërkon nga Dhoma e Posaçme që propozimin e paditësit për masën e sigurimit ta refuzojë në tërësi dhe ta obligojë atë për shpenzimet e kësaj procedure.

Më 22 gusht 2019 Zyrtarja e Financave e Dhomës së Posaçme ka lëshuar vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore lidhur me propozimin për masën e sigurimit në shumë prej 100 euro. Paditësi është paralajmëruar se nëse taksa nuk paguhet brenda 15 ditëve nga data e pranimit, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Sipas fletkthesës në shkresa të lëndës, urdhri është dorëzuar dy herë d.m.th. më datën 24 gusht 2019 dhe më 26 gusht 2019 por pala (G.R.) gjendet në Zvicër me familje dhe se shtëpia është e mbyllur.

Dërgimi i vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore është përsëritur më 2 shtator 2019 në adresë të avokatit përfaqësues S.R..

Për detaje tjera referim behet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për masë të sigurimit është e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Sipas Nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Dhomën e Posaçme), Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Sipas formulimit të mësipërm Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme, ndërsa në rastin konkret nuk është paraqitur ndonjë rrethane nga ana e paditësve, me anë të së cilës do të bëhej i besueshëm fakti se dëmi është i menjëhershëm dhe i pa riparueshëm.

Paditësi i cili kërkon urdhër paraprak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të riparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek paditësi, kështu që paditësi përveç që duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i riparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Në këtë aspekt gjykata konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 për caktimin e masës së sigurimit, pasi që paditësi nuk pritët të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe të riparueshëm, meqë sipas kërkesave ligjore përveç që duhet të bëhet e besueshme e drejta e pretenduar, duhet që paditësi të dorëzon dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të riparueshme nëse nuk miratohet kërkesa.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren përmes përgjigjes në kërkesë të paditësit, e lëshuar më 11 dhjetor 2015 me nr. 07-029-212840/Z, e ka njoftuar paditësin se ngastra 608/7 është pronë private e cila figuron në emër të personave privat (Sh.H.dhe D.H.) ndërsa sipas historiatit ngastra kadastrale nr. 605/10 nuk ekziston fare.

Paditësi ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme masë të sigurimit për ngastrën kadastrale nr. **608/7** në sipërfaqe prej 9 ari e 22m² ZK D dhe ngastra kadastrale nr. **605/10** në sipërfaqe prej 13 ari e 70 m² ZK D, të cilat fare nuk janë në emër të NSH-së.

Në rastin konkret, pa paragjykuar rrezikun në të ardhmen dhe themelësinë e kërkesës kryesore, një rrezik i tillë nuk ekziston, pasi që parcelat kontestuese që janë objekt i këtij

kontesti janë në emra të personave fizik dhe se AKP-ja si e paditur nuk paraqet kurrfarë rreziku për tjetërsimin e pronave në fjalë.

Pra nisur nga fakti se propozimi për caktimin e masës e sigurisë është parashtruar nga paditësi në atë drejtim që parcelat që janë objekt kontesti, të mos mund të tjetërsohen/ngarkohen dhe duke marr parasysh argumentet e lartcekura se një rrezik i tillë i pretenduar nuk ekziston, gjykata vlerëson se kërkesa për masë të sigurimit është e pa bazuar.

Paditësi, në të ardhmen mund të paraqesin një kërkesë të re për lëshimin e masës së sigurimit, nëse e paditura me veprime konkrete tenton ta tjetërsoj apo ngarkoj objektin e kontestit, por tani për tani një rrezik i tillë nuk ekziston.

Nga arsyet e theksuara Gjykata konstaton se propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi tanimë e ka paguar taksën gjyqësore lidhur me kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 €, sipas urdhërpagesës së datës 2 shtator 2019 dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Teuta Ibrahim, Gjyqtare Kryesuese _____

Manushe Karaçi, Gjyqtare _____

Hajrie Shala, Gjyqtare _____